



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivery	25.11.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	5672/2021	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity

SRPMSACK



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.866/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, Jeton Kocanëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.866/2021 të datës 13.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adrese Rr. "Amalin, banesa e Arianit, përball dillonit kati i VII nr.44 në Vushtrri, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.866/2021 e datës 13.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas akt emërimit të datës 16.09.2020 në pozitën Inspektor Tatimor (deri më datën 20.09.2021 ku përmes e-mailit ka ofruar dorëheqje), i cili me datën 13.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5013/2021 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rimbursimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në trajnime profesionale, të cilit me datën 17.05.2021 i është bërë rimbursimi në shumën prej 140 euro nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Ankuesi z. i pakënaqur me këtë pagesë e cila i është bërë për pjesëmarrje në trajnime profesionale me datën 13.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5013/2021 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Më datë 02.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/29.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.10.2021 me numër protokollit 4152/2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 16.09.2021 me nr.02/1164/11; Ëtifikatë e muajit nëntor 2020; Marrëveshje për pjesëmarrjen në trajnim e datës 06.05.2021; Formulor i regjistrimit; Udhëzimi mbi rimbursimin e shpenzimeve të trajnimeve profesionale i datës 08.09.2015; E-mail zyrtar i datës 02.02.2021; E-mail zyrtar i datës 10.03.2021; E-mail i datës 24.03.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 06.05.2021; E-mail zyrtar i datës 02.04.2021; E-mail zyrtar i datës 23.06.2021; E-mail zyrtar i datës 01.04.2021; Kërkesë me shkrim e datës 01.07.2021; E-mail zyrtar i datës 06.10.2021; E-mail zyrtar i datës 05.10.2021; E-mail zyrtar i datës 23.07.2021; E-mail zyrtar i datës 06.05.2021; E-mail zyrtar i datës 23.06.2021; Vendim i datës 23.09.2021 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së; E-mail zyrtar i datës 01.06.2021; E-mail zyrtar i datës 23.06.2021; E-mail zyrtar i datës 06.10.2021; E-mail zyrtar i datës 23.06.2021; E-mail zyrtar i datës 06.05.2021; E-mail zyrtar i datës 02.04.2021; E-mail zyrtar i datës 01.04.2021; E-mail zyrtar i datës 23.06.2021; E-mail zyrtar i datës 06.05.2021; E-mail zyrtar i datës 02.04.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; Urdhër obligimi për pagesë i datës 17.05.2020; dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 02.11.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/29.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nga Administrata Tatimore e Kosovës nuk është bërë rimbursimi në pajtim me Udhëzimin mbi rimbursimin e shpenzimeve të trajnimeve profesionale i datës 08.09.2015. Ankuesi përmes e-mailave zyrtar ka kërkuar nga Menaxherja e trajnimeve në Administratën Tatimore të Kosovës ti bëhet rimbursimi i shpenzimeve të trajnimeve, pasi që në vitin e kaluar është certifikuar dhe ka marrë titullin "Teknik i Kontabilitetit".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që në shkresat lëndës të cilat i ka sjell ankuesi kemi një shkresë Marrëveshje për pjesëmarrje në trajnim të datës 06.05.2021 e cila marrëveshje nuk është e nënshkruar as nga menaxheri i trajnimeve dhe as nga zëvendës Drejtori, dhe në këtë marrëveshje përcaktohet shuma 304 euro, i cili ka ndjekur trajnimin prej datës 03.09.2020 dhe ka përfunduar me datën 09.11.2020. Ankuesi në e-mailin e datës 24.03.2021 ka kërkuar që ti bëhet pagesa edhe për 104 euro e cila llogaritet pagesë për diplomë dhe tarifë të asocimit për Teknik të Kontabilitetit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të gjitha provave të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, me datën 19.11.2021 kemi kërkuar nga menaxherja e trajnimeve në Administratën Tatimore të Kosovës të na njoftoj se a është bërë rimbursimi për shpenzimet e trajnimit për z. po të njëjtën ditë përmes e-mailit zyrtar menaxherja e trajnimeve përmes e-mailit na ka njoftuar se bazuar në Udhëzimin për Rimbursimin e Shpenzimeve të Trajnimeve Profesionale është realizuar pagesa ndaj poashtu ka bashkangjitur edhe urdhër obligimin për pagesë të datës 17.05.2021 ku është realizuar pagesa në shumën prej 140 euro.

Ankuesi i pakënaqur me këtë pagesë me datën 23.06.2021 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga Drejtori për Shërbime Juridike dhe Udhëheqësi i divizionit për standarde profesionale ka kërkuar interpretim ligjor lidhur me Udhëzimin për Rimbursimin e Shpenzimeve të Trajnimeve Profesionale në pjesën e dispozitivit ku theksohet se “lejohet rimbursimi i shpenzimeve / pagesave pa u kufizuar për : trajnimin për kontabilist dhe auditorë, provimin e jurisprudencës si dhe çdo trajnim tjetër të ngjashëm”. Me të njëjtën datë përmes e-mailit zyrtar kanë njoftuar ankuesin se përmes ankesës bazuar në nenin 24, paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ti drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.866/2021,datë 24.11.2021

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

